



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PORTI DETAR SHA SARANDË
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. . Prot.

Sarandë, më.17.03.2025

PROCESVERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Materiale Pastrimi, Detergjentë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

44411000-4 Sanitare, 33771000-5 Produkte sanitare letre, 33711900-6; sapuni,39224100-9; fshese,39224330-0; kove, 39224320-7; sfungjer, 39831200-8- Detergjente, 33761000-2- leter higjenike, 24311900-6- klor, 39830000-9- produkte pastrimi, 39831300-9- pastrues dysHEMEJE, 39831600-2- pastrues tualeti

PROCEDURA : "E hapur e thjeshtuar" Mall, (elektronikë).

BURIMI: Vetëfinancim

AFATI : 8 muaj

REFERENCA : Programi Ekonomik i Shoqërisë për vitin 2025

NJËSIA E PROKURIMIT: Urdhër Nr.6 datë 13.03.2025

Krenar Bedaj - Kryetar

Rovena Ali - Anëtar

Kosti Gogo - Anëtar

VLERA E FONDIT LIMIT: 1.200.000 (një milion e dyqind mijë) lekë pa TVSH.

KODI OUTPUT: 0000000

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Porti Detar Sha Sarandë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 83:

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 26,605 (njëzet e gjashtë mijë e gjashtëqind e pesë) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

c. *Formulari i ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3*

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik" dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, cdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Shtojcës 1 dhe Shtojcës 3 të Dokumenteve Standarte të Tenderit.

d. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

Shënim: Kjo kërkesë do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Njësia e Prokurimit e ka hartuar këtë kriter duke u bazuar në pikën 7, gërma "a", neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

b) Të jetë i specifikuar në QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtë ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, nenin 40 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 40% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qenë se lloji i procedurës është “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, gërma “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar.....”;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për Vitin 2024 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar). Për të vërtetuar këtë kriter duhet paraqitur një deklaratë për shlyerjen e detyrimeve vendore ose vërtetim nga organet e njësisë vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, deklaratën ose vërtetimin nga organet e njësisë vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.

Shënim: Ky kriter (2.2.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin

nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (furnizimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për furnizime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë Çertifikatën të vlefshme ISO 9001 ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme.

Organi i vlerësimit të konformitetit të certifikatave ISO të kërkuara për operatorin ekonomik ofertues duhet të jetë i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose nga një organizëm ndërkombëtar akreditues i njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me certifikatën ISO 9001:2015. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kësaj procedurë. Me certifikimin e mësipërm operatori pjesëmarrës të provojnë se ka një sistem të menaxhimit të cilësisë, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht mallra cilësore që plotësojnë kërkesat të AK-së dhe është i përkushtuar për përmirësimin e vazhdueshëm.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

2.3.3 Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mëposhtëme, të shoqëruara me (Skedat teknike).

Skedat duhet të jenë në gjuhën shqipe dhe nëse janë në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer e të noterizuara. Në skedat teknike duhet të dallohet qartë përputhja e të gjitha karakteristikave (specifikimeve teknike) të kërkuara me produktet e ofruara.

Nr. sipas Preventivit	Emërtimi
1	Qeska mbeturinash 140 litorshe
4	Letër higjenike e paketuar (një rolo)
6	Solucion larës dyshemeje (pllakash)
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%
11	Shtupa pambuku për larje dyshemeje
14	Sapun i lëngshëm

Operatori ekonomik ditën e zhvillimit të tenderit duhet të paraqesë fizikisht mostrat për artikujt e tabelës së mësipërme (nga një moster për secilin artikull).

- Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit në ambjentet e protokollit të AK.
- Çdo moster e paraqitur pas orarit të përcaktuar për hapjen e procedurës nuk do të pranohet.
- Mostrat e kërkuara duhet detyrimisht të jenë të vulosura me vulën e ofertuesit, emrin e ofertuesit, datën e zhvillimit të tenderit, të nënshkruara në vende të dallueshme dhe të ketë numrin rendor korespondues me emrin e artikullit.
- Mostrat duhet të përputhen me cilësimet e dhëna në specifikimet përkatëse. Nëse mostrat nuk janë sipas specifikimeve OE do të skualifikohet.

- Mosparaqitja e mostrave, skedave teknike ditën e zhvillimit të tenderit është kusht për skualifikimin e operatoreve.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 6 “a”, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe Udhezimit të APP-së Nr.3 datë 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë” Kriteri i vendosur për paraqitjen e mostrave është kërkuar për të siguruar AK-ja, për plotësimin e kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike ku mostra e kërkuar do të shfaqë cilësinë e produktit final i cili do të lëvrohet nga OE fitues gjatë gjithë zbatimit e kontratës.

2.3.4 Subjekti ofertues, në lidhje me periodicitetin e lëvrimin të mallit, duhet të paraqesë deklaratën si mëposhtë:

- a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë me shkrim që merr përsipër me mjetet dhe punonjësit e vetë të realizojë furniturat e mallrave objekt prokurimi në kohë dhe në sasi sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe grafikut të lëvrimin, në jo më pak se 8 (tetë) furnizime në ambjentet e Autoritetit Kontraktor.
- b) Operatori ekonomik duhet të deklarojë se nëse shpallet fitues, mallrat do të jenë të njëjtë me mostrat e paraqitura ditën e zhvillimit të procedurës së prokurimit.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për skadencën e mallrave, e cila duhet të jetë jo më pak se 1 (një) vit nga momenti i lëvrimin të mallit.

Mosdeklarimi si më sipër, përbën kusht për skualifikim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 15 pika 3/b, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenin 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që "Në procedurat e prokurimit për mallra, autoriteti/enti kontraktor parashikon sasinë e mallrave që do të lëvrojë, si dhe grafikun e lëvrimin të mallrave".

Argumentohet si më poshtë:

Vendosja e këtij kriteri ka ardhur sepse hapësirat e magazinimit të mallit të institucionit janë aktualisht tepër të kufizuara.

SHËNIM: Në zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”, **sjellim në vëmendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t'i dërgojë kërkesë në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njëjësuar me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s'kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik".
- Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bera gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht s'kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT

Sasia e mallit që kërkohet:

Furnizimet do të jenë me bazë mujore, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, në jo më pak se 8 (tetë) lëvrime (furnitura).

Afati i levrimit të mallit do të jetë 8 (tetë) muaj nga nënshkrimi i kontratës, sipas nevojave të Autoritetit Kontraktor të paraqitura në grafikun e levrimit.

Periudha e dorëzimit të mallit do të jetë në një nga pesë ditët e para të çdo muaji, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës.

GRAFIKU I LËVRIMIT TË MALLIT

Artikujt	Njësia	Muaji I	Muaji II	Muaji III	Muaji IV	Muaji V	Muaji VI	Muaji VII	Muaji VIII	SASIA TOTALE
Qeska mbeturinash 140 litroshe	kg	80	100	100	100	80	80	30	30	600
Qeska mbeturinash 100 litroshe	kg	50	50	50	50	50	50	50	50	400
Qeska mbeturinash 35 litroshe	pako	40	40	40	40	40	40	30	30	300
Letër higjenike e paketuar (min 10 rulon/paketim)	pako	50	100	100	100	100	100	50	50	650
Acid për pastrim	litër	20	20	40	40	20	20	20	20	200
Solucion larës dysHEMEJE (pllakash)	litër	100	100	100	100	100	100	100	50	750
Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	litër	100	100	100	100	100	100	100	100	800
Sfungjer enësh i thjeshtë	copë	50								50
Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	pako	50	50							100
Doreza Latex ose Nitrile	pako	50	50							100
Shtupa pambuku për larje dysHEMEJE	cope	100								100
Bishta fshese/shtupe	copë	50								50
Fshesë pastrimi pa bisht	copë	50								50
Sapun i lëngshëm	litër	50	80	80	80	80	50	50	30	500
Shtrydhëse, veçmas kovës (Lecka për pastrim pllakash)	copë	10								10

Kovë plastike me shtrydhje	copë	10								10
Solucion për zhblokim lavamani	1 liter	20								20
Solucion kundra smërçit /kriprave nga hidrosanitaret me mekanizëm sprucimi	liter	10								10
Furça për pastrimin e WC-së	copë	10								10
Fshesë merimangash me shklop	copë	5								5
Solucion larës xhamash	750 ml	30								30
Aromatik tualeti	125 gr	50								50
Letër guzhine e paketuar (10m)	rolo			10	10	10	10	10		50
Solucion larës enësh lëng	litër	5	5	5	5	5	5			30
Insekticid për bletë/miza/milingona	litër	10	10	10	10	10				50
Solucion për heqjen e vajrave nga sipërfaqe betoni	kg	39	23	23	23	23	23	23	23	200

Afatet e lëvrimit:

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
Materiale pastrimi, detergjentë.	Sipas specifikimeve teknike (Shtojca 6)	Sipas grafikut të lëvrimit	Porti Detar Sarandë	8 (tetë) muaj

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Nr	Artikujt	Njësia	Specifikimet Teknike
1	Qeska mbeturinash 140 litroshe	kg	Material plastik I fortë
2	Qeska mbeturinash 100 litroshe	kg	Material plastik I fortë
3	Qeska mbeturinash 35 litroshe	pako	Të jenë rezistente, të kenë kapacitet mbajtës min 35 litër dhe të përmbajë min 15 fije, të jenë të forta, materiali plastmasi. Të jenë të paketuara në formë ruloje. Gryka e qeses të jetë pa ose me lidhëse. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
4	Letër higjenike e pakeluar (min 10 rulon/paketim)	pako	Të jetë me paketim min 10 rulon/pako, fletëpalosje zig-zag në pako me fije dhe me shkëputje. Të jetë cilësore dhe e butë. Të jetë e tretshme në ujë.
5	Acid për pastrim	1 litër	Të jetë solucion efikas në heqjen e kripërave të depozituara si dhe papastërtive. Zbardhës alkaline me aftësi vepruese dezinfektante. Ambalazhimi në shishe plastike. Të përmbajë në masën 12% deri në 30% acid klorhidrik. Vlera e pH 0-3. Densiteti i acidit të jetë 1.0 deri 1.5 gr/cm ³ . Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
6	Solucion larës dyshemeje (pllakash)	1 liter	Me veti të mira pastruese dhe aromatizuese. Ambalazhimi në shishe plastike. Gjendja fizike: të jetë solucion lëng, me aromë parfumi. Vlera e PH të jetë 5 deri në 10. Paraqitja fizike e solucionit të jetë homogjene. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Densiteti të jetë 0.9 gr/cm ³ -1.1 gr/cm ³ . Përmbajtja e lëndëve tensioaktive të jetë jo më shumë se 10%. I përshtatshëm për vende higjienike, dhoma zhveshje, palestra dhe kudo ku ka probleme arome të pakëndshme. Ambalazhimi në bidon plastik me konfeksione sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
7	Hipoklorit Natriumi NaOCl 10-12%	litër	Ku përmbajtja e klorit aktiv të jetë 10-12%. Përmbajtja e alkalitetit jo më shumë se 5%, të mos ketë përmbajtje të lëndëve të ngurta, të ketë ngjyrë të verdhë deri në kafe të çelët, me erën karakteristike shpues në hundë. Ambalazhimi të jetë me bidona plastik të përshtatshëm që ti rezistojnë efektit shpues të “klorit”. Ambalazhimi të jetë i etiketuar ku të paraqitet titulli i klorit aktiv. Të jetë cilësor

8	Sfungjer enësh i thjeshtë	copë	Të jenë të përdorshëm për pastrim pjatash, tenxheresh dhe kazanësh. Të jenë me pore të vogla në përbërjen e sfungjerit dhe me rrjete teli të butë për pastrim sipërfaqesh të ashpra.
9	Peceta pluhrash të thjeshta (3 fije/pako)	pako	Të jenë të paketuara në qese min 3 fije/pako. Të jenë me shumë se një përdorimëshe. Të kenë veti të mira përthithëse
10	Doreza Latex ose Nitrile	pako	Josterile, me ose pa pudër, njëpërdorimëshe, në masat XS, S, M, L, XL (sipas kërkesës së punonjësve), të jenë të paketuara në pako kartoni ose plastike, me minimumi 100 copë/pako. Të ketë çertifikimin CE ose FDA ose ekuivalent. Afati i skadencës të jetë të jetë të paktën 6 muaj nga koha e furnizimit. Të ambalazhuara në mënyrë të tillë që të mos kontaminohen gjatë shpërndarjes.
12	Shtupa pambuku për larje dysHEMEJE	copë	Përbërë nga fibra tekstili me përbërje mikrofibër që thithin ujin shumë mirë. Dendësia e shtupës të jetë jo më e vogël se 250 gr. T'i bashkëngjitet shtupës, shkopi me veshje plastike me gjatësi normale, jo më të shkurtër se 100 cm, të jetë me efekt vidhimi. Materiali i shkopit të jetë alumini nga brenda dhe plastik nga jashtë.
13	Bishta fshese/shtupe	copë	Shkop për fshesa/shtupa Përmasat: 100-180 cm. Materiali inoks. Filetoja të pershtatet për shtupen e pastrimit
14	Fshesë për pastrim territori, melakuqi	copë	Fshesa të jetë me fije të dendura, të buta plastike, me gjatësi mbi 10 cm. Të jetë për pastrim të ambienteve të brendshme. Të jenë rezistente gjatë forcës së fshirjes së sipërfaqes. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme me mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim me shkopin. Vendi i vendosjes së shkopit të jetë standard. Peshë e saj të jetë jo më e vogël se 340 gr.
15	Sapun i lëngshëm	litër	Ambalazhimi nga fabrika në shishe plastike me mekanizëm në pjesën e trupit të shishes për manovrim të produktit gjatë përdorimit. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion viskoz dhe homogjen. Të mos jetë irritues me lëkurën e duarve. Vlera e PH jo më vogël se 5.5 dhe jo më e madhe se 8. Densiteti i lëngut të jetë 0.9 deri në 1.1 Faqe 14 nga 27 gr/cm ³ . Aromë parfumi. Tretshmëria në ujë 100%. Lëndët tensioaktive të jenë nga 5.0 deri në 11%. Të ketë emërtimin e markës tregtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës
16	Shtrydhëse, veçmas kovës (Lecka për pastrim pllakash)	copë	Të jetë e përbërë në trup me material plastik të fortë dhe doreza të jetë plastike.
17	Kovë plastike me shtrydhje	copë	Të jetë plastike, e thellë dhe të kenë një dorezë mbajtëse nga sipër për transportimin e kovës, kova të jetë së bashku me kapakun e shtrydhjes së shtupës. Kapaciteti mbajtës të jetë me volum min 10 Litër

19	Solucion për zhbllokim lavamani	litër	Me efekt zhbllokimi të shpejtë, të mos krijojë shkumë dhe të mos dëmtojë tubat plastike. Ambalazhimi në qese plastike ose kuti kartoni trajtë pluhuri sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës.
21	Solucion kundra smërçit /kriprave nga hidrosanitarët me mekanizëm sprucimi	litër	Ambalazhimi në shishe plastike për larje të lavamanit, sanitaret e tualetit, të pastrojë në thellësi kripërat e ujit nga hidrosanitarët. Të parandalojë krijimin e kripërave. Të ketë aromë parfumi dhe substanca mbrojtëse për lëkurën e duarve. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjene. Vlera e PH jo më e madhe se 2.5 dhe jo më e vogël se 1.5. Të jetë i tretshëm në ujë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës
23	Furça për pastrimin e WC-së	copë	Të jetë me fije të forta sintetike. Furçë për pastrim efikas dhe higjienik për pastrimin e sipërfaqeve të vështira. Furça të ketë mbajtësen e saj. Të jetë me peshë jo më shumë se 300 gr.
24	Fshesë merimangash me shkop	copë	Fshesa për pastrimin e merimangave, të jetë e përbërë me fije të dendura e të buta plastike me gjatësi mbi 10 cm. Koka të jetë e montueshme dhe e çmontueshme. Bishti të jetë i gjatë jo më i shkurtër se 100 cm, i përbërë nga materiali metalik i veshur me një shtesë plastike. Fshesa dhe shkopi të kenë mekanizmin e rrotullimit nga e djathta në montim
27	Solucion larës xhamash	750 ml	Me efekt pastrimi dhe shkëlqim të xhamave. Ambalazhimi në shishe plastike me mekanizëm sprucimi. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë homogjen, të ketë aromë parfumi. Vlera e PH 5 deri në 11. Të jetë i tretshëm në ujë 100%. Solucioni të jetë homogjen dhe të ketë densitet 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të variojë nga 1.0% deri në 4.0%.
32	Aromatik tualeti	125 gr	Me efekt pastrimi dhe dezinfektimi. Të jetë aromatizues në formë sapuni të cilat vendosen brenda në kasetën e tualetit ose brenda në anën e ËC-së
33	Letër guzhine e paketuar (10m)	rolo	Letra të jetë e paketuar, standard me rula. Të jetë cilësore. Të jetë 10 m dhe të jetë me shkëputje.
34	Solucion larës enësh lëng	litër	Me efekt pastrimi të thellë. Ambalazhimi në shishe plastike dhe të ketë analizën spektrale në etiketë. Të ketë emërtimin e markës tregëtare dhe barkodin e prodhimit të fabrikës. Gjendja fizike e lëngut të jetë solucion homogjen dhe viskoze, të ketë aromë parfumi. Tretshmëria në ujë të jetë 100%. Vlera e PH 6 deri në 10. Faqe 13 nga 27

			Densiteti të variojë nga 0.9 gr/cm ³ deri në 1.2 gr/cm ³ . Lënda tensioaktive të jetë nga 15% deri në 20%.
35	Insekticid për bletë/miza/milingona	litër	Insekticid për ambiente të brendshme. Të jetë me aromë jo shumë të fortë. Të jetë produkt i biodegradueshëm.
36	Solucion për heqjen e yndyrnave nga betoni	kg	Solucion për heqjen e yndyrnave nga sipërfaqet e betonit

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, te LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas shkresës Nr.2065 Prot, datë 12.04.2022.

Në specifikimet teknike që janë hedhur në dokumentet teknike të tenderit nuk është përmendur asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **01.04.2025, ora 10:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt: “**Materiale pastrimi, detergjentë**”, Njësia e Prokurimit përcaktoi anëtarin e NJP znj.R.Ali.

Bashkëlidhur këtij proces-verbali:

- Dokumentat standarte të tenderit
- Njoftimi i shkurtuar i kontratës

NJËSIA E PROKURIMIT